



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 3 regjistër (JR)  
Datë 13.01.2022

Nr. 4 i vendimit  
Datë 11.03.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 11.03.2022, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonçi Petković, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 3/2022 (JR), datë 13.01.2022, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Skënder Damini, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 485, datë 14.12.2021.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet A, F dhe G të Aneksit të Kushtetutës; nenet 56, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Skënder Damini, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni, ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë. Për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 22.03.2019, Komisioni vendosi fillimin e hetimit administrativ mbi procedurën e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Skënder Damini. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.11.2021, Komisioni vendosi përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në relacionin paraprak vetëm për kriterin e pasurisë, njoftimin e subjektit mbi rezultatet e hetimit dhe kalimin e barrës së provës mbi këto rezultate, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me të drejtën e tij për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni dhe të drejtat procedurale që ai gëzon në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative.
3. Në datën 17.11.2021, pas marrjes së rezultateve të hetimit paraprak, subjekti i rivlerësimit Skënder Damini, i përfaqësuar nga Av. J. M.<sup>1</sup>, nëpërmjet një shkrese përcjellëse të protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.11.2021, ka njoftuar këtë të fundit se në të njëjtën datë subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për dorëheqje të parevokueshme, në zbatim të neneve 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, një kopje të së cilës ia ka përcjellë bashkëlidhur shkresës drejtuar Komisionit.
4. Në datën 02.12.2021, KLGj-ja i ka përcjellë Komisionit<sup>2</sup> vendimin e saj nr. 547, datë 23.11.2021, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Vlorë, z. Skënder Damini”, me anë të të cilit ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Skënder Damini, për shkak të dorëheqjes së tij, me efekt nga data 31.12.2021.
5. Komisioni, në datën 10.12.2021, nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail* në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit, i ka bërë me dije atij përcjelljen nga KLGj-ja të vendimit nr. 547, datë 23.11.2021, me anë të të cilit ka miratuar kërkesën për dorëheqje të z. Skënder Damini, duke deklaruar për pasojë edhe mbarimin e statusit të tij të magjistratit. Në të njëjtin komunikim, Komisioni ka informuar subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore dhe në vijim e ka ftuar atë të shprehë vullnetin nëse dëshiron të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.12.2021, në përgjigje të këtij komunikimi elektronik, ka informuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

<sup>1</sup> Sipas prokurës së posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.11.2021, përpara noteres S. K. B.

<sup>2</sup> Nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 02.12.2021, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 03.12.2021.

6. Në datën 13.12.2021, Gjykata Administrative e Apelit, në përgjigje të kërkesës së Komisionit<sup>3</sup>, ka informuar këtë të fundit<sup>4</sup> se z. Skënder Damini, deri në datën 10.12.2021, nuk ka paraqitur ankim përpara Gjykatës Administrative të Apelit kundër vendimit nr. 547, datë 23.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
7. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Skënder Damini, me vendimin nr. 485, datë 14.12.2021.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

8. Komisioni, me vendimin nr. 485, datë 14.12.2021, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, vendosi:
  1. *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Skënder Damini, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.*
  2. *Ndalimin e emërimit të z. Skënder Damini si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.*

[...]

## **III. Shkaqet e ankimit**

9. Subjekti i rivlerësimit Skënder Damini, më datë 30.12.2021, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 485, datë 14.12.2021, duke kundërshtuar vetëm pikën 2 të tij me përmbajtje: *Ndalimin e emërimit të z. Skënder Damini si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*
10. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka dhënë një vendim në mosrespektim të ligjit, duke trajtuar gabim të drejtën e fituar me ligj të magjistratit për dorëheqje, për sa kohë aktin e dorëheqjes nga ana e subjektit të rivlerësimit e ka interpretuar si një akt që duhet të sjellë domosdoshmërisht pasojën e humbjes së statusit të magjistratit dhe ndalimin e ushtrimit të profesionit për një periudhë 15-vjeçare. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo pjesë e dispozitivit të vendimit vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, me garancitë juridike mbi të drejtën për privatësi që ofron neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ( në vijim “KEDNj”), si dhe është marrë në shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor.
11. Subjekti i rivlerësimit Skënder Damini kërkoi nga Kolegji që, pas shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e tij, të vendosë:
  - ° *Ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 485, datë 14.12.2021, të Komisionit.*
12. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

<sup>3</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 09.12.2021.

<sup>4</sup> Nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 13.12.2021, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 13.12.2021.

**12.1** Komisioni ka interpretuar gabim dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit, të dhënë në kuadër të parashikimeve të nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, si dorëheqje në kuptim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

**12.2** Lidhur me procesin e zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit pretendon se është cenuar e drejta e tij për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e faktit se ai nuk është dëgjuar nga Komisioni lidhur me dorëheqjen e dhënë përpara KLGj-së dhe se atij i është dhënë një masë drastike për ndalimin e ushtrimit të profesionit për një periudhë kaq të gjatë.

**12.3** Ndalimi i subjektit për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për një periudhë prej 15 vitesh vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.

**12.4** Pika 2 e vendimit objekt ankimi vjen në kundërshtim me garancitë juridike mbi të drejtën për privatësi që ofron neni 8 i KEDNj-së, pasi sjell pasoja të rënda për jetën private të subjektit të rivlerësimit në drejtim të aktivitetit profesional të tij.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Skënder Damini, dhe për të cilin ai, nëpërmjet ankimit, kërkon ndryshimin e pikës 2 të tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

14. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>5</sup>, nga

---

<sup>5</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 485, datë 14.12.2021, për rivlerësimin e subjektit Skënder Damini, i është njoftuar atij me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.12.2021, konfirmuar marrja dijani në datën 20.12.2021, sipas lajmërimarrjes përkatëse. Ndërsa ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 30.12.2021, protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.12.2021. Në këto kushte, subjekti rezultoi të ketë ushtruar ankim në ditën e 10-të të afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 485, datë 14.12.2021, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
16. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, konstatoi se vendimi për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Skënder Damini, si pasojë e dorëheqjes së tij nga detyra përpara KLGj-së, ishte marrë nga Komisioni më datë 14.12.2021, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit, referuar vendimit të KLGj-së nr. 547, datë 23.11.2021, vijonte të gëzonte statusin e magjistratit, si pasojë e faktit se vendimi i sipërcituar i KLGj-së, për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Skënder Damini, do t'i prodhonte pasojat juridike të parashikuara në datën 31.12.2021.
17. Referuar situatës faktike si më sipër trajtuar, në konsideratë edhe të parashikimit ligjor të nenit 100, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas të cilit, ndaj aktit administrativ individual të KLGj-së mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të aktit<sup>6</sup>, si dhe në mungesë të konfirmimit nga ana e KLGj-së për moskundërshtim nga ana e subjektit Skënder Damini të aktit administrativ të këtij organi brenda afatit ligjor, trupi gjykues, me qëllim verifikimin e marrjes formë të prerë të vendimit të KLGj-së për mbarimin e statusit të magjistratit për subjektin Skënder Damini, me vendim të ndërmjetëm të datës 03.03.2022, vendosi t'i kërkojë KLGj-së informacion nëse subjekti i rivlerësimit Skënder Damini kishte ushtruar ose jo ankim kundër vendimit të këtij Këshilli nr. 547, datë 23.11.2021. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues e shtyu gjykimin e çështjes në datën 11.03.2022.
18. Në përgjigje të kërkesës së trupit gjykues, KLGj-ja, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 09.03.2022, pasi kishte marrë më parë informacion nga Gjykata Administrative e Apelit<sup>7</sup>, informoi Kolegjin se, deri më datë 07.03.2022, ndaj vendimit të KLGj-së nr. 547, datë 23.11.2021, nuk ishte paraqitur ankim.
19. Trupi gjykues, në vijim të gjyqimit të çështjes në dhomë këshillimi, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkonin korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr.

<sup>6</sup> Referuar nenit 98, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, njoftimi i akteve administrative individuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me statusin e gjyqtarëve bëhet në një ose disa nga format e mëposhtme: a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit; b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës së marrësit; c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.

<sup>7</sup> Nëpërmjet shkresës së Gjykatës Administrative të Apelit nr. {\*\*\*} prot., datë 07.03.2022.

49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

#### *B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit*

20. *Lidhur me shkakun e ankimit për zbatim në mënyrë të gabuar nga Komisioni të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit subjekti pretendon se dorëheqja e tij nga detyra, e dhënë në kuadër të nenit 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është vlerësuar në mënyrë të gabuar nga Komisioni, si dorëheqje nga detyra në kuptim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
21. *Komisioni në vendimin e tij ka arsyetuar lidhur me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit si vijon: Trupi gjykues mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësimi ex officio, në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nënparagrafëve “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës, realizohet, përfundimisht, nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe në ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit ex officio, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në të njëjtën frymë arsyeton edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, ku shprehet: “Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga detyra e gjyqtarit. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se, për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në këtë nen do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*
22. *Në shqyrtimin e këtij shkakui të ankimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes dhe konstatoi të provuara faktet juridike të evidentuara nga ana e Komisionit si bazë për vendimmarrjen e tij, si dhe kontrolloi arsyetimin përkatës në vendimin objekt ankimi, vlerësoi se zbatimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës prej tij është bërë në mënyrë të drejtë dhe bazuar në situatën faktike të kërkuar nga kjo dispozitë kushtetuese.*

23. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se dorëheqja e tij nga detyra është dhënë bazuar në parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe, si e tillë, nuk duhej t’i nënshtrohej zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, gjendet i pabazuar nga trupi gjykues. Kolegji çmon se togfjalëshi “*që dorëhiqet sipas kësaj dispozite*”, në përmbajtjen e pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, nuk nënkupton vendosjen e një kriteri kushtetues sipas të cilit aplikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës kushtëzohet me referimin apo jo të kësaj dispozite kushtetuese në aktin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit. Për rrjedhojë, dorëheqja nga detyra e magjistratit, e cila pasohet nga vendimi i këshillit përkatës për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, sjell si pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio*, në kuadër të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, duke përmbushur në këtë mënyrë kriteret kushtetuese të përcaktuara shprehimisht për zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Ky qëndrim i konsoliduar i Kolegjit në vendimmarrje të mëparshme<sup>8</sup>, lidhur me pretendime të së njëjtës natyrë me këto të ngritura nga subjekti i rivlerësimit Skënder Damini, në mbështetje të shkakut të ankimit për zbatim të gabuar të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, vjen në harmoni të plotë edhe me arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, ku shprehet: *Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*
24. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi vlerësoi se Komisioni ka zbatuar drejt parashikimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit nga detyra që ushtronte në periudhën gjatë së cilës kryhej procesi i rivlerësimit kalimtar, si pasojë e së cilës humbi statusin e magjistratit, sipas neneve 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, deklaruar kjo me vendimin nr. 547, datë 23.11.2021, të KLGj-së, i cili rezultoi që në momentin e gjykimit kishte marrë formë të prerë, e gjen të pabazuar në fakte dhe në ligj shkakun e ankimit për zbatim të gabuar të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
25. *Lidhur me shkakun e ngritur në ankim për cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni i ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar lidhur me dorëheqjen e dhënë përpara KLGj-së, dhe se ai nuk mund të hamendësonte se ky akt dorëheqjeje do të passillte marrjen e masave drastike për ndalimin e ushtrimit të profesionit për një periudhë kaq të gjatë, në kushtet kur, me dhënien e dorëheqjes, ndërpritej procesi i rivlerësimit nga ana e Komisionit.
26. Trupi gjykues çmon fillimisht të theksojë se në dritën e jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, sa i takon respektimit dhe garantimit të së drejtës së subjekteve të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 të KEDNj-së, Kolegji ka vlerësuar se në çështjet e rivlerësimit për të cilat Komisioni ka vendosur ndërprerjen e procesit në kuadër të zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, e drejta e subjekteve për t’u dëgjuar nga organet e rivlerësimit lidhur me rezultatin e pritshëm të kësaj procedure përpara marrjes së vendimit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, është thelbësore, për sa kohë ndërprerja e

<sup>8</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 17 (JR), datë 25.07.2019, dhe nr. 18 (JR), datë 29.07.2020.

procesit të rivlerësimit sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës shoqërohet me pasoja juridike në drejtim të ecurisë së karrierës së subjektit në sistemin e drejtësisë, konkretisht me ndalimin e ushtrimit të funksioneve të caktuara në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, për një periudhë kohore prej 15 vitesh.

27. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi dhe pasi konstatoi se Komisioni nuk ka zhvilluar një seancë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Skënder Damini, vlerësoi të nevojshëm verifikimin e procedurave të ndjekura prej tij, me qëllim vlerësimin nëse mosmbajtja e seancës dëgjimore nga ana e Komisionit është apo jo në përputhje me parashikimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

28. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit, u konstatua si më poshtë.

28.1. Trupi gjykues i Komisionit në datën 10.12.2021, nëpërmjet një komunikimi elektronik me *e-mail*, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit Skënder Damini se ka administruar shkresën e KLGj-së nr. {\*\*\*} prot., datë 02.12.2021, me anë të së cilës është përcjellë vendimi i kësaj të fundit nr. 547, datë 23.11.2021, për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit Skënder Damini, si pasojë e dorëheqjes së tij nga detyra. Në vijim, në këtë *e-mail*, Komisioni është shprehur: *Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të së drejtës suaj për t'u dëgjuar dhe bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ju kërkon të shprehni vullnetin tuaj nëse dëshironi ose jo, të merrni pjesë në seancë dëgjimore, fokusi i së cilës do të jetë ndërprerja e procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit G, paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës. Ju lutem konfirmoni nëse do të shfrytëzoni të drejtën për të marrë pjesë në seancën dëgjimore që do t'ju njoftohet në vijim, apo hiqni dorë nga kjo e drejtë.*

28.2. Në datën 13.12.2021, nga subjektin e rivlerësimit, në adresë të Komisionit është përcjellë një *e-mail* me tekst: [...] *Duke ju falënderuar për dhënien e së drejtës sime, ju njoftoj se NUK dua të marr pjesë në seancën dëgjimore. Ngelem i hapur për çdo informacion tjetër, të konsideruar të nevojshëm nga ana juaj.*

29. Në shqyrtim të fakteve të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vlerësoi se mosdëgjimi i subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore në Komision, ka ardhur si pasojë e vullnetit të vetë atij. Referuar përmbajtjes së komunikimit elektronik, rezultoi që Komisioni ka qenë i qartë në identifikimin e pasojave të cilat priteshin të vinin për subjektin e rivlerësimit, si rrjedhojë e deklarimit të mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, sa kohë e ka orientuar subjektin e rivlerësimit që fokusi i seancës dëgjimore do të ishte zbatimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, duke evidentuar në mënyrë të shprehur, jo vetëm paragrafin 1 në të cilin përcaktohet pasoja juridike e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, në rast dorëheqjeje nga detyra, por edhe në paragrafin 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, në të cilin përcaktohet shprehimisht ndalimi i emërimit në funksione të caktuara në sistemin e drejtësisë, për një periudhë të caktuar prej 15 vitesh.

30. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se, referuar edhe qëndrimin të mbajtur në vendimin e Kolegjit nr. 17 (JR), datë 06.07.2021, ky shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit



nuk gjendet i bazuar në fakte dhe, si i tillë nuk e bën të cënueshëm vendimin e Komisionit në drejtim të respektimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

31. Sa i takon shkakut të ankimit lidhur me pikën 2 të vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo pjesë e dispozitivit që konsiston në vendosjen e një ndalimi për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, për një periudhë prej 15 vitesh, vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky parim është shkelur pasi nga Komisioni nuk është vlerësuar situata ligjore e subjektit të rivlerësimit në momentin që është depozituar vendimi i KLGj-së për miratimin e dorëheqjes. Sipas subjektit, sanksioni i vendosur nga Komisioni nuk ka konsideruar tri elementet e testit të proporcionalitetit mes sanksionit dhe situatës juridike që ka të bëjë me faktin që çdo masë e organeve duhet të jetë: (i) e përshtatshme dhe efikase; (ii) e nevojshme; dhe (iii) proporcionale. Gjithashtu, ai u shpreh se sanksioni i vendosur nga Komisioni në pikën 2 të vendimit objekt ankimi, është ekstrem, aq sa zhvishet nga natyra administrative dhe kanalizohet në fushën penale, madje duke tejkaluar dhe dënimet penale.
32. Sa i takon shqyrtimit të këtij shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit lidhet me çështje ligjore të interpretimit të paragrafit 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për të cilën Kolegji ka krijuar tashmë jurisprudencë të konsoliduar<sup>9</sup>, sipas së cilës ka arsyetuar se vlerësimi nëse kufizimi i parashikuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i gjykimit në Kolegji, për sa kohë që ai është një parashikim kushtetues dhe Kolegji nuk ka diskrecion vlerësimi në këtë drejtim. Sikundër dhe vetë masa e kufizimit për të qëndruar 15 vite jashtë sistemit të drejtësisë, është përcaktuar nga kjo dispozitë kushtetuese, si një periudhë e caktuar, fikse, dhe jo e vendosur në marzhe, rast në të cilin vlerësimi i institucioneve të rivlerësimit për efekt të përcaktimit të periudhës së kufizimit, do t'i nënshtrohej parimit të proporcionalitetit. Në arritjen e këtij përfundimi, Kolegji ka mbajtur parasysh edhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017 (V-2/17)<sup>10</sup>.
33. Në kuadër të sa më sipër, dorëheqja e subjektit të rivlerësimit Skënder Damini nga detyra e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë, u vlerësua nga trupi gjykues si një akt vullneti i lirë për të ndërprerë detyrën funksionale që e bënte atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës. Kjo dorëheqje është shqyrtuar nga ana e KLGj-së dhe vendimi përkatës i këtij institucioni kushtetues nuk rezultoi të jetë kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, Kolegji çmoi se ishte detyrë e subjektit të rivlerësimit të merrte parasysh që pasojat juridike që do të sillte dorëheqja e tij nga detyra, referuar parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, do të shtriheshin jo vetëm në drejtim të ecurisë së procesit të rivlerësimit duke e ndërprerë atë, por edhe në vijimësinë e karrierës së tij në sistemin e drejtësisë, duke i vendosur këtij të fundit një ndalim të përkohshëm prej 15 vitesh, në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara shprehimisht në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në

<sup>9</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 17/2019, 38/2020, 41/2020, 6/2021, 17/2021 etj.

<sup>10</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën e "Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike", me objekt "Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", shih paragrafin nr. 63.

kushtet kur këto pasoja juridike gëzojnë statusin e parashikimit kushtetues, trupi gjykues çmoi se vlerësimi i ashpërsisë dhe i proporcionalitetit të tyre nuk mund të jetë objekt i procesit gjyqësor në Kolegj, pasi ky i fundit nuk ka asnjë diskrecion vlerësimi në këtë drejtim. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosvlerësim nga ana e Komisionit të tri elementeve të testit të proporcionalitetit, lidhur me masën e vendosur në pikën 2 të vendimit të Komisionit, gjenden të pabazuara në ligj.

34. Ndërsa sa u takon pretendimeve lidhur me natyrën penale të sanksionit dhe ashpërsinë e tij, trupi gjykues rithekson se pretendime të tilla, në çështje të mëparshme të ngjashme me çështjen objekt gjykimi, janë gjetur nga Kolegji si të pabazuara në ligj, me arsyetimin se kufizimi i përkohshëm i së drejtës për t'u emëruar në pozicionet e sipërcituara, nuk kualifikohet në legjislacionin e brendshëm dhe të posaçëm për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si një dënim penal, ai nuk është rrjedhojë e një procesi me natyrë penale, si dhe nuk jepet nga një gjykatë penale. Ky kufizim i përkohshëm i së drejtës të subjekteve të rivlerësimit për t'u emëruar në pozicionet e përcaktuara shprehimisht në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është vlerësuar nga kushtetutëbërësi si pasoja juridike që rrjedh në të gjitha rastet kur subjektet e rivlerësimit, në saje të vullnetit të tyre, humbasin cilësinë subjektive për të qenë pjesë e procesit të rivlerësimit kalimtar, dhe ky proces ndërpritet pa një vendim përfundimtar lidhur me rivlerësimin e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, edhe në rastin objekt gjykimi, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar, as në fakte, as në ligj.
35. Gjithashtu, edhe sa i takon shkakut të ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendoi se pika 2 e vendimit objekt ankimi vjen në kundërshtim me garancitë juridike mbi të drejtën për privatësi që ofron neni 8 i KEDNj-së, pasi sjell pasoja të rënda për jetën private të tij në drejtim të aktivitetit profesional, trupi gjykues vlerësoi se, për sa kohë vendimmarrja e Komisionit, në zbatim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, ka ardhur si pasojë e vullnetit të qartë dhe të parevokueshëm të subjektit të rivlerësimit për të mos ushtuar detyrën e gjyqtarit, vullnet i cili i ka dhënë fund karrierës në sistemin e drejtësisë, duke njohur parashikimet e ligjit për pasojat që vijnë në këto rrethana, pretendimet për cenim të nenit 8 të KEDNj-së gjenden jo vetëm të pabazuara, por edhe të paarsyeshme. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Kolegji dhe në çështje të ngjashme<sup>11</sup>.
36. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 485, datë 14.12.2021, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Skënder Damini dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit objekt shqyrtimi, është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

---

<sup>11</sup> Shih vendimin e Kolegjit nr. 17/2021, parag. 20.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 485, datë 14.12.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Skënder Damini.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 11.03.2022, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*